



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 50 9- 15 Dhjetor 2019

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 rrethe ose 100% (=36/36) e tyre

1 rreth ose 3% (=1/36) e tyre kanë raportuar me telefon, faks, postë:
HAS

35 rrethe ose 97% (=35/36) e tyre kanë raportuar me postë elektronike:

BERAT, BULQIZË, DELVINË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIË, KUÇOVË, KUKËS, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, M. MADHE, MALLAKASTËR, MAT, MIRDITË, PEQIN, PËRMET, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, asnjë rreth ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 50

	JAVA 50
DIARRE PA GJAK	1.182
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	6.647
INF. RESP. TE POSHTËME	3.427
RASH ME TEMPERATURË	8
VERDHEZA	2
HEMORRAGJI ME TEMPERATURË	0
SUSPEKT MENINGITIS	0
ETHE TË PASHPJEGUESHME	0
Numri i Njësive Raportuese	398
% e Njësive Raportuese	93% (398/427)

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog 8 raste si më poshtë nuk janë të dyshuara për fruth dhe rubeolë por për varicelë:

Fier – 6 raste

Lushnje– 2 raste


Të dyshuar për Fruth janë 1 rast nga rrethi i Lushnjes dhe 1 rast nga rrethi i Krujës.

Verdhëza


Rastet janë grupmoshës 45-59 vjeç dhe 60+ vjeç të raportuar nga rrethi i Fierit. Një prej rasteve u dyshua për Leprospirozë ndërsa ne rastin tjetër diagnoza rezultoi me natyrë jo infektive.

Infeksione respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqitet e qëndrueshme në javën e 50 krahasuar me javën paraardhëse, java 49.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet rënie në javën 50 krahasuar me javën paraardhëse, java 49.

Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 40 – 50 të vitit 2018 dhe të vitit 2019. Numri i rasteve.




Në javën e 50 të vitit 2019 vërehet një prirje e qëndrueshme e numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 15% më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës në javën 50 të vitit 2019. Numri i rasteve dhe Incidenca (raste/10.000)




Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000



Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas rretheve në javën 49 dhe 50 të vitit 2019. Incidenca (raste/10.000)




Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët 40 – 50 të vitit 2018 dhe të vitit 2019. Numri i rasteve.



Në javën 50 të vitit 2019 vërehet prirje në rënie e numrit të rasteve të “Diarre pa gjak” dhe ky numër është 6% më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas rretheve në javën 49 dhe javën 50 të vitit 2019. Incidenca (raste/10.000)



Nga komunikimi me rrethet Durrës, Lezhë, Krujë dhe Tiranë, si edhe me rrethet e tjera të vendit shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Nivelet e Raportimit për javën e 50 sipas rretheve, në përqindje.

